

**LIGJ**  
**Nr.10 173, datë 22.10.2009**

**PËR MBROJTJEN E DËSHMITARËVE DHE TË BASHKËPUNËTORËVE TË  
DREJTËSISË\***

*(Ndryshuar me ligjet nr.10 461, datë 13.9.2011, nr. 32/2017, datë 30.3.2017)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1  
**Objekti**

Ky ligj rregullon masat e posaçme, të përkohshme dhe të jashtëzakonshme, mënyrën dhe procedurat e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, si dhe organizimin, funksionimin, kompetencat dhe marrëdhëniet ndërmjet organeve të ngarkuara për propozimin, vlerësimin, miratimin dhe zbatimin e programit të mbrojtjes.

Neni 2  
**Fusha e veprimit**

Dispozitat e këtij ligji janë të zbatueshme në kuadër të procedimeve penale për krime të kryera me dashje, për të cilat ligji parashikon dënim me burgim jo më pak se 4 vjet, në minimum. Rrezikshmëria e këtyre krimeve dhe e autorëve të tyre duhet të jetë e tillë, që të justifikojë kryerjen e shpenzimeve të nevojshme për mbrojtjen e një ose të disa personave.

Neni 3  
**Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Programi i mbrojtjes” janë masat e posaçme, ndihmëse dhe të jashtëzakonshme, që zbaton Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, për mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të personave të mbrojtur, në kushtet e parashikuara nga ky ligj.

2. “Dëshmitar i drejtësisë” është personi, i cili, në cilësinë e dëshmitarit ose të personit të dëmtuar, bën deklarime a dëshmon për fakte e rrethana, që përbëjnë objekt prove në një procedim penal dhe që, për shkak të këtyre deklarimeve a dëshmive, ndodhet në gjendje rreziku.

3. “Bashkëpunëtor i drejtësisë” është personi, i cili vuan dënimin penal ose është i pandehur në një procedim penal për krime të kryera në bashkëpunim, që ndodhet në gjendje

---

\* Ligji nr.10 173, datë 22.10.2009 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 154, datë 16 nëntor 2009.  
Ligji nr.10 461, datë 13.9.2011 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 135, datë 3 tetor 2011.  
Ligji nr. 32/2017, datë 30.3.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 92, datë 2 maj 2017.

rreziku, për shkak të bashkëpunimit me drejtësinë, të deklarimeve apo dëshmime për fakte e rrethana, që përbëjnë objekt prove në të njëjtin procedim penal ose në një procedim të lidhur.

4. “Persona të lidhur” janë personat, të cilët ndodhen në gjendje rreziku, për shkak të lidhjeve të gjakut, të martesës, të bashkëjetesës së faktit ose marrëdhënieve të ngushta personale, që kanë me dëshmitarin ose me bashkëpunëtorin e drejtësisë.

5. “Persona të mbrojtur”, bashkërisht ose veçmas, janë dëshmitarët, bashkëpunëtorët e drejtësisë dhe personat e lidhur me ta, sipas përcaktimeve të bëra në pikat 2, 3 e 4 të këtij neni.

6. “Gjendje rreziku” është gjendja aktuale, konkrete dhe serioze, për shkak të së cilës jeta e shëndeti janë në rrezik, si pasojë e dëshmitarit të dëshmitarit apo të bashkëpunëtorit të drejtësisë në procesin penal, për veprat penale të parashikuara në këtë ligj.

## KREU II ORGANET PËRGJEGJËSE PËR MBROJTJEN E DËSHMITARËVE DHE TË BASHKËPUNËTORËVE TË DREJTËSISË

### Neni 4

#### **Organet përgjegjëse**

Organe përgjegjëse për përgatitjen, vlerësimin, miratimin dhe zbatimin e programit të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë janë:

a) Komisioni për Vlerësimin e Programit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, më poshtë komisioni;

b) Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, më poshtë drejtoria.

### Neni 5

#### **Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë**

*(ndryshuar pika 1 dhe ndryshuar fjalë në pikën 2 dhe 3 me ligjin nr. 32/2017, datë 30.3.2017)*

1. Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, si strukturë e posaçme qendrore në Policinë e Shtetit, është organi përgjegjës për përgatitjen, ndjekjen dhe zbatimin e programit të mbrojtjes. Drejtoria e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Struktura dhe organika e drejtorisë miratohen nga Ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

3. Drejtoria ka buxhetin e vet, si njësi shpenzimi në buxhetin e Drejtorisë së Policisë së Shtetit. Administrimi i pasurive dhe fondeve të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së drejtorisë, dokumentimi i shpenzimeve dhe kontrolli i veprimtarisë financiare të drejtorisë bëhen në mënyrë të tillë, që të mos lejojnë identifikimin e të dhënave me natyrë sekrete e operative.

4. Trajtimi dhe përfitimet e punonjësve të drejtorisë rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

### Neni 6

#### **Detyrat e drejtorisë**

*(shtuar fjalë me ligjin nr. 32/2017, datë 30.3.2017)*

Drejtoria ka këto detyra:

a) përgatit dhe dërgon për shqyrtim në komision propozimet e dërguara nga Prokurori i Përgjithshëm ose Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, për pranimin në programin e mbrojtjes;

b) kryen një vlerësim të kushteve fizike dhe psikologjike të personit të propozuar për t'u pranuar në programin e mbrojtjes dhe një vlerësim të gjithanshëm të gjendjes së rrezikut, me

qëllim që komisioni të jetë sa më i informuar për përshtatshmërinë e personit me programin e mbrojtjes;

c) vendos zbatimin e masave të përkohshme të mbrojtjes, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga komisioni, në rastet dhe mënyrën e parashikuar në nenin 18 të këtij ligji;

ç) zbaton masat e posaçme dhe ndihmëse të mbrojtjes, që do të zbatohen për personin ose personat e pranuar në program, pas marrjes së vendimit të komisionit për pranimin në programin e mbrojtjes;

d) përgatit dhe nënshkruan marrëveshjen e mbrojtjes me personat e mbrojtur, sipas nenit 19 të këtij ligji;

dh) ndjek zbatimin e programit të mbrojtjes;

e) administron bazën e të dhënave, që lidhet me veprimtarinë e drejtorisë dhe ecurinë e programit të mbrojtjes dhe merr masa për t'i siguruar e administruar ato, në përputhje me shkallën e nevojshme të klasifikimit të informacionit, sipas dispozitave ligjore në fuqi;

ë) administron pasuritë dhe fondet në dispozicion të drejtorisë për ushtrimin e veprimtarisë dhe zbatimin e programit të mbrojtjes, përfshirë marrjen me qira të mjediseve të nevojshme për punë teknike e operative;

f) propozon dhe merr masa për bashkërendimin e punëve me institucione të tjera për zbatimin e programit të mbrojtjes ndaj personave të mbrojtur;

g) ndjek çështjet e bashkëpunimit me strukturat ndërkombëtare ose të shteteve të tjera në fushën e mbrojtjes;

gj) përgatit raporte periodike për veprimtarinë e zhvilluar dhe bën propozime për përmirësimin e legjislacionit, për zbatimin e programit të mbrojtjes ndaj personave të mbrojtur. Raportet e drejtorisë përmbajnë vetëm statistika. Asnjë dispozitë ligjore për të drejtën e informimit nuk e vë drejtorinë para detyrimit për t'u dhënë informacion, qoftë edhe në mënyrë të përmblodhur e të reduktuar, institucioneve shtetërore, shtypit apo publikut. Raportet periodike përgatiten çdo gjashtë muaj dhe i vihen në dispozicion komisionit.

## Neni 7

### **Kompetenca të veçanta të drejtorisë**

1. Drejtoria, kur e sheh të nevojshme, në funksion të zbatimit të masave të mbrojtjes, u drejtohet, me një kërkesë të arsyetuar, me shkrim, institucioneve të tjera shtetërore:

a) për informacionin e nevojshëm;

b) për të mos u dhënë informacion enteve ose personave që, në kushte normale, kanë të drejtë ta marrin këtë informacion;

c) për t'i informuar, në çdo rast, kur persona ose ente të tjera bëjnë përpjekje të marrin informacion për personat e mbrojtur.

2. Drejtoria, në zbatim të programit të mbrojtjes, ka të drejtë të përdorë identitete të rreme dhe t'u kërkojë institucioneve të tjera shtetërore të ndihmojnë në krijimin e tyre:

a) për personat e mbrojtur;

b) për punonjësit e drejtorisë, që kryejnë detyra konkrete, në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga ky ligj.

3. Për efekt të përjashtimit nga përgjegjësia penale, personat që përdorin identitete të rreme, në zbatim të pikës 2 të këtij neni dhe funksionarët publikë, që ndihmojnë në krijimin e këtyre identiteteve, vlerësohen se kanë vepruar në ushtrim të një të drejte ose në zbatim të detyrës së ngarkuar nga ligji, sipas nenit 21 të Kodit Penal.

## Neni 8

### **Emërimi, lirimi dhe përjashtimi nga policia i punonjësve të drejtorisë**

*(shtuar dhe ndryshuar fjalë me ligjin nr. 32/2017, datë 30.3.2017)*

1. Oficerët e policisë në drejtori përzgjidhen nga radhët e punonjësve të policisë, që plotësojnë kriteret për t'u emëruar në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, në përputhje me ligjet e aktet nënligjore në fuqi.

2. Kandidatët për punonjës të drejtorisë i nënshtrohen verifikimit të personalitetit të tyre nga struktura përgjegjëse për kontrollin e brendshëm në ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.

3. Transferimi i oficerëve të policisë të drejtorisë në një detyrë tjetër në Policinë e Shtetit bëhet në përputhje me procedurën e parashikuar në ligjin që rregullon veprimtarinë e Policisë së Shtetit, vetëm me pëlqimin paraprak, me shkrim, të oficerit.

4. Marrja e masave disiplinore për punonjësit e drejtorisë dhe ankimi ndaj tyre bëhet në bazë të ligjit që rregullon veprimtarinë e Policisë së Shtetit.

#### Neni 9

### **Komisioni për Vlerësimin e Programit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë**

*(shtuar pika 7 me ligjin me ligjin nr.10 461, datë 13.9.2011, ndryshuar fjalë me ligjin nr. 32/2017, datë 30.3.2017)*

1. Komisioni për Vlerësimin e Programit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë është organi përgjegjës që vlerëson dhe miraton propozimet e drejtorisë për:

- a) pranimin në programin e mbrojtjes;
- b) masat konkrete të mbrojtjes;
- c) ndërprerjen e programit;
- ç) përfundimin e këtij programi.

Komisioni ka kompetencë edhe shqyrtimin e ankesave të bëra në përputhje me nenin 26 të këtij ligji.

2. Komisioni kryesohet nga zëvendësministri në ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike dhe në përbërje të tij ka:

- a) një gjyqtar të propozuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në detyrën e zëvendëskryetarit;
- b) një prokuror të propozuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë në detyrën e anëtarit;
- c) një oficer të policisë gjyqësore të propozuar nga Drejtori i Policisë së Shtetit në detyrën e anëtarit;
- ç) drejtori i drejtorisë në detyrën e anëtarit.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Drejtori i Policisë së Shtetit caktojnë edhe nga një anëtar zëvendësues, të cilët do të marrin pjesë në mbledhjet e komisionit, kur ekziston një arsye, që i ndalon anëtarët respektivë të marrin pjesë në mbledhjet e komisionit.

4. Anëtarët e komisionit caktohen në detyrë për një afat trevjeçar, me të drejtë riemërimi. Anëtarësia në komision përfundon përpara afatit:

- a) kur anëtari nuk ushtron më funksion në institucionin që e ka propozuar, ose për shkak të të cilit është emëruar;
- b) me kërkesën e vet, të shoqëruar me arsye të bazuara;
- c) për shkak të mungesës së pajustificuar në dy mbledhje radhazi të komisionit;
- ç) për shkelje të dispozitave të këtij ligji dhe të rregullave të funksionimit të komisionit.

5. Vendimi për përfundimin e qëndrimit në detyrë të anëtarit të komisionit merret nga organi përgjegjës për emërimin e tyre. Në rastin e shkronjës “b” të pikës 4 të këtij neni, vendimi merret me kërkesë të vetë anëtarit, ndërsa në rastin e shkronjave “c” e “ç”, me kërkesë të komisionit.

6. Gjyqtari, prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore, anëtarë të komisionit, nuk mund të marrin pjesë në diskutim dhe në vendimmarrje, kur vihen në dijeni se propozimi për pranim në program ka lidhje me procedime penale apo veprimtari, që hetohen ose gjykohen prej tyre. Ky

ndalim vlen edhe kur ka konflikt interesash ose dyshime për njëanshmëri, të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale dhe në dispozitat e tjera ligjore në fuqi. Në raste të tilla, ata zëvendësohen nga anëtarët zëvendësues.

7. Kryetari dhe anëtarët e komisionit marrin shpërblim financiar në masën dhe mënyrën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

### KREU III PROGRAMI PËR MBROJTJEN E DËSHMITARËVE DHE TË BASHKËPUNËTORËVE TË DREJTËSISË

#### Neni 10

#### **Kushtet e përgjithshme për zbatimin e programit të mbrojtjes**

1. Kur zbatimi i masave të zakonshme të mbrojtjes për dëshmitarin ose bashkëpunëtorin e drejtësisë nuk është i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm, zbatohet programi i mbrojtjes, sipas këtij ligji, nëse ai pranon të bashkëpunojë me vullnet të lirë me prokurorinë dhe gjykatën dhe, nëpërmjet deklarimeve dhe/ose dëshmisë së vet të plotë, të bërë pa kushte dhe rezerva, të japë të dhëna të bazuara, që përbëjnë prova vendimtare për zbulimin, hetimin dhe gjykimin e krimeve dhe të autorëve të tyre.

2. Zbatimi i programit të mbrojtjes për dëshmitarin ose bashkëpunëtorin e drejtësisë vendoset vetëm nëse ai ndodhet në gjendje rreziku, është i përshtatshëm për t'u përfshirë në program dhe, me vullnetin e vet të lirë, pranon e merr pjesë aktivisht në zbatimin e tij.

3. Përshtatshmëria ka të bëjë me kushtet psikologjike, sociale dhe fizike të dëshmitarit ose të bashkëpunëtorit, të cilat duhet të jenë të tilla, që të krijojnë besim se ai do të zbatojë rregullat e programit të mbrojtjes dhe nuk do të vërë në rrezik jetën e shëndetin e vet, jetën e shëndetin e personave të tjerë. Nëse ka mundësi, ndaj tij merret masa e ndryshimit të vendbanimit, si dhe e programit në tërësi.

4. Në rastin e dëshmitarit ose të bashkëpunëtorit të mitur, përveç rrethanave të mësipërme, duhet të vlerësohen edhe pasojat e pranimin në program për zhvillimin e tij psiko-social.

5. Në varësi të rrethanave konkrete, bashkë me dëshmitarin ose bashkëpunëtorin e drejtësisë mund të përfshihen në programin e mbrojtjes edhe personat e lidhur me të. Edhe në këtë rast zbatohen rregullat që parashikohen në pikat 1 e 2 të këtij neni.

6. Programi i mbrojtjes nuk ka për qëllim të sjellë përmirësimin e gjendjes ekonomike të personit të mbrojtur. Drejtoria, komisioni dhe asnjë institucion tjetër shtetëror nuk përgjigjen për detyrimet financiare, që personat e mbrojtur kanë në çastin e pranimin në programin e mbrojtjes.

#### Neni 11

#### **Kohëzgjatja e programit të mbrojtjes**

1. Programi i mbrojtjes, si rregull, zbatohet për një afat të pacaktuar dhe mund të shtrihet në të gjitha fazat e procedimit penal, si dhe pas përfundimit të tyre.

2. Kohëzgjatja e zbatimit të programit të mbrojtjes varet nga ekzistenca e gjendjes së rrezikut, përshtatshmëria e personit të mbrojtur, në raport me masën e posaçme të mbrojtjes që zbatohet, si dhe nga zbatimi, prej personit të mbrojtur, i detyrimeve të parashikuara në marrëveshjen e mbrojtjes.

#### Neni 12

#### **Masat e mbrojtjes**

*(ndryshuar shkronja "d" me ligjin nr. 32/2017, datë 30.3.2017)*

Në kuadër të programeve të mbrojtjes, një ose disa nga masat e mbrojtjes që zbatohen për personat e mbrojtur janë:

- a) ndryshimi i identitetit;
- b) ndryshimi i vendbanimit;
- c) dhënia e dokumenteve të rreme;
- ç) mbrojtja e përkohshme e identitetit, e të dhënave dhe e dokumenteve;
- d) dhënia e dëshmisë me një identitet tjetër dhe administrimi me mjete të veçanta për deformimin e zërit a të pamjes së tij dhe forma të tjera të caktuara sipas ligjit, në përputhje me nenin 361/b të Kodit të Procedurës Penale;
- dh) mbrojtja fizike dhe teknike në vendin ku qëndron personi, si dhe gjatë lëvizjeve të tij;
- e) rehabilitimi social;
- ë) dhënia e ndihmës financiare;
- f) rikualifikimi profesional;
- g) dhënia e këshillave dhe e ndihmës së specializuar ligjore;
- gj) çdo masë tjetër, e cila vlerësohet dhe miratohet si e nevojshme në përputhje me këtë ligj.

#### Neni 13

### **Përgjegjësia për zbatimin e programit të mbrojtjes**

1. Drejtoria përgjigjet për përgatitjen, bashkërendimin e punëve dhe ndjekjen e zbatimit të programit të mbrojtjes.
2. Drejtoria bashkëpunon me ministritë dhe institucionet e tjera qendrore për çështje që kanë të bëjnë me ndjekjen dhe zbatimin e programit të mbrojtjes.
3. Organet e përmendura në pikën 2 të këtij neni bashkërendojnë punën e tyre me drejtorinë, u përgjigjen kërkesave të kësaj drejtorie dhe të prokurorit, si dhe njoftojnë për çështje e rrethana, që kanë të bëjnë me zbatimin e programit të mbrojtjes.

#### Neni 14

### **Administrimi i akteve, i dokumentacionit dhe i informacionit**

1. Aktet, dokumentacioni dhe çdo informacion, që lidhet me propozimin, miratimin dhe zbatimin e programit të mbrojtjes, vlerësohen “Informacion i klasifikuar” dhe mbahen e administrohen nga Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.
2. Aktet, dokumentacioni, të dhënat, si dhe çdo informacion, që zotërojnë dhe administrojnë ministritë e institucionet e tjera qendrore, për programin e mbrojtjes, vlerësohen “Informacion i klasifikuar”.

#### KREU IV

### **PROCEDURAT PËR MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E PROGRAMIT TË MBROJTJES**

#### Neni 15

### **Propozimi për praninë në programin e mbrojtjes**

*(shtuar dhe hequr fjalë me ligjin nr. 32/2017, datë 30.3.2017)*

1. Të drejtën për të propozuar praninë e një ose të disa personave në programin e mbrojtjes e ka Prokurori i Përgjithshëm ose Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.
2. Propozimi për praninë e një ose të disa personave në programin e mbrojtjes përmban, domosdoshmërisht, të dhënat e mëposhtme:
  - a) të dhëna personale të personit, që propozohet të mbrohet;

b) shpjegime për rëndësinë e deklarimeve të bëra apo që mund të sigurohen nga dëshmitari ose bashkëpunëtori i drejtësisë, si dhe arsyet përse dhënia e lirë e dëshmimeve nuk mund të sigurohet në mënyrë tjetër;

c) rrethanat në të cilat ose për shkak të të cilave dëshmitari a bashkëpunëtori i drejtësisë ka marrë dijëni për të dhënat dhe deklaratimet, që ka bërë ose që mund të sigurohen prej tij;

ç) të dhëna dhe shpjegime të tjera, që shërbejnë për të motivuar e mbështetur vlerësimin për gjendjen e rrezikut, ku ndodhet apo parashikohet të ndodhet personi, që propozohet të mbrohet;

d) informacione për gjendjen financiare të dëshmitarit;

dh) informacione të tjera, sipas vlerësimit të prokurorit.

3. Në rastin e bashkëpunëtorit të drejtësisë, propozimi shoqërohet me përshkrimin e kushteve të bashkëpunimit me drejtësinë, të cilat do të bëhen pjesë e marrëveshjes së mbrojtjes, sipas nenit 37/a dhe 37/b të Kodit të Procedurës Penale.

#### Neni 16

### **Shqyrtimi i propozimit për pranimin në programin e mbrojtjes**

*(shtuar fjalë me ligjin nr. 32/2017, datë 30.3.2017)*

1. Propozimi i Prokurorit të Përgjithshëm ose i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme për pranimin e një ose të disa personave në programin e mbrojtjes, së bashku me informacionin bazë, sipas nenit 13 të këtij ligji, depozitohen pranë Drejtorisë së Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe të Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, e cila kryen edhe funksionet e sekretarisë teknike. Kjo drejtori ia përcjell praktikën për shqyrtim kryetarit të komisionit jo më vonë se 24 orë nga data e depozitimit të saj.

2. Prokurori i Përgjithshëm ose Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, kur është rasti, së bashku me propozimin, i paraqet drejtorisë një kërkesë, ku parashtrohen edhe arsyet, sipas së cilës kjo drejtori, në përputhje me rrethanat konkrete, të zbatojë masa të përkohshme mbrojtjeje, derisa të përfundojë shqyrtimi i propozimit të tij nga komisioni.

3. Me marrjen e propozimit, kryetari i komisionit ngarkon drejtorinë të kryejë vlerësimin e kushteve fizike dhe psikologjike të personit të propozuar për t'u pranuar në programin e mbrojtjes, vlerësimin e gjithanshëm të gjendjes së rrezikut, si dhe përshtatshmërinë e personit me programin. Për vlerësimin e gjendjes së rrezikut, drejtorja mund t'i kërkojë dëshmitarit, bashkëpunëtorit të drejtësisë ose personave të lidhur me ta informacion për çdo shkelje të mëparshme të ligjit të kryera prej tij, pavarësisht nëse është dënuar për ato ose jo. Në rastet kur bëhen deklaratime për vepra penale të kryera nga dëshmitari, bashkëpunëtori i drejtësisë ose personat e lidhur me ta, drejtorja njofton menjëherë Prokurorin e Përgjithshëm ose Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme për të riparë kërkesën vetëm për qëllimin e parashikuar në këtë pikë.

#### Neni 17

### **Vendimmarrja e komisionit**

*(shtuar fjalë me ligjin nr. 32/2017, datë 30.3.2017)*

1. Mbledhjet e komisionit thirren nga kryetari brenda 5 ditëve nga dorëzimi në drejtori i propozimit të Prokurorit të Përgjithshëm ose Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme. Në raste të veçanta dhe urgjente ky komision mblidhet menjëherë.

2. Mbledhjet e komisionit janë të vlefshme, kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve të tij. Vendimet e tij janë të vlefshme, kur miratohen nga tre anëtarë të pranishëm në mbledhje.

3. Komisioni merr vendim jo më vonë se 10 ditë nga mbledhja e parë dhe, në çdo rast, jo më vonë se 15 ditë nga data e depozitimit në drejtori të propozimit të Prokurorit të Përgjithshëm ose Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe të dokumentacionit përkatës.

4. Rregullat dhe procedurat e parashikuara në këtë nen zbatohen edhe në rastet e

ndërprerjes dhe të përfundimit të programit të mbrojtjes.

Neni 18

**Masa të përkohshme të mbrojtjes**

*(shtuar fjalë me ligjin nr. 32/2017, datë 30.3.2017)*

1. Në raste të veçanta dhe urgjente, drejtoria, me kërkesën e prokurorit që procedon, vendos zbatimin e menjëhershëm të masave të përkohshme të mbrojtjes. Për këtë qëllim, drejtoria dhe personi i mbrojtur nënshkruajnë një marrëveshje të përkohshme mbrojtjeje. Prokurori i Përgjithshëm ose Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme duhet të paraqesë propozimin për pranimin e personit në programin e mbrojtjes brenda 30 ditëve nga data e fillimit të zbatimit të masave të përkohshme.

2. Masat e përkohshme të mbrojtjes vendosen në përputhje me gjendjen e rrezikut, në forma të tilla, që garantojnë, përkohësisht dhe paraprakisht, nivelin e domosdoshëm të mbrojtjes.

Neni 19

**Marrëveshja me personin e mbrojtur**

*(shtuar fjalë me ligjin nr. 32/2017, datë 30.3.2017)*

1. Në një kohë sa më të shkurtër dhe në çdo rast, jo më vonë se 10 ditë nga data e miratimit të pranimit në programin e mbrojtjes, drejtoria përgatit marrëveshjen për zbatimin e programit (marrëveshjen e mbrojtjes) dhe merr masa për bisedimin dhe nënshkrimin e saj me dëshmitarin, bashkëpunëtorin e drejtësisë dhe personat e tjerë të mbrojtur.

2. Përpara se të nënshkruhet marrëveshja, bashkëpunëtori i drejtësisë detyrohet të informojë drejtorinë me hollësi për llojet dhe masën e pasurive të zotëruara prej tij. Nëse ndonjë nga pasuritë, që zotërohen nga bashkëpunëtori i drejtësisë, është produkt i veprave penale, e ardhur ose përfitim nga produktet e veprës penale, apo pasuritë, me të cilat janë përzier këto produkte, atëherë personi duhet ta deklarojë këtë fakt. Në rastet kur bëhet një deklaram i tillë, drejtoria njofton menjëherë Prokurorin e Përgjithshëm ose Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme.

3. Drejtoria vë në dijeni Prokurorin e Përgjithshëm ose Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme për nënshkrimin e marrëveshjes së mbrojtjes. Përmbajtja e marrëveshjes, hollësitë për vendndodhjen e personit apo të identitetit të tij të ri nuk i bëhen të ditura Prokurorit të Përgjithshëm ose Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme ose prokurorit që procedon, kurse vendndodhja dhe identiteti i tij i ri nuk duhet t'i bëhen të ditur as komisionit.

4. Përgjegjësitë dhe efektet e programit të mbrojtjes për drejtorinë dhe personin e mbrojtur fillojnë në kohën dhe mënyrën e parashikuar në marrëveshje.

5. Në rastin kur personi i mbrojtur është i mitur ose është madhor, por i është hequr a kufizuar zotësia për të vepruar, në përputhje me parimet e interesit më të lartë të tij dhe ato të zotësisë për të vepruar, atij i merret mendimi për pranimin në program dhe për përmbajtjen e marrëveshjes. Në këto raste, dhënia përfundimtare e pëlqimit dhe nënshkrimi i marrëveshjes së mbrojtjes bëhen nga prindi ose kujdestari i tij.

6. Marrëveshja e mbrojtjes nuk është marrëdhënie detyrimi, në kuptim të Kodit Civil. Personi i mbrojtur ose trashëgimtarët e tij nuk mund të kërkojnë në gjykatë ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje dhe as dëmshpërblim, në rastet kur marrëveshja nuk është ekzekutuar apo kur ai pretendon se i ka ardhur ndonjë dëm.

Neni 20

**Përmbajtja e marrëveshjes**

1. Në marrëveshjen e mbrojtjes parashikohen, detyrimisht, këto çështje:
  - a) detyrimet e personave të mbrojtur;



b) masat e posaçme dhe ndihmëse, që do të merren nga drejtoria për të ofruar mbrojtjen e duhur, sipas nivelit dhe rrethanave të rrezikut;

c) rastet dhe rrethanat e ndryshimit dhe të ndërprerjes së programit të mbrojtjes;

ç) rastet e pranimit vullnetar të programit të mbrojtjes nga personi i mbrojtur;

d) kushtet e bashkëpunimit me drejtësinë, në rastin e bashkëpunëtorëve të drejtësisë.

2. Marrëveshja e mbrojtjes parashikon, gjithashtu, rregullimin më të hollësishëm të përmbushjes, nga personat e mbrojtur, të kushteve dhe detyrimeve, si më poshtë:

a) të pranojë kushtet dhe udhëzimet e përcaktuara për programin e mbrojtjes dhe të bashkëpunojë në mënyrë aktive për zbatimin e tyre;

b) të mbajë parasysh natyrën e informacionit të klasifikuar dhe, në çfarëdo rrethane, të mos bëjë të ditur asnjë të dhënë për programin e mbrojtjes dhe të dhëna të tjera të lidhura me të, duke u paralajmëruar për përgjegjësi penale, sipas nenit 295/a të Kodit Penal, në rast të shkeljes së detyrimit për të ruajtur sekretin, që lidhet me programin e mbrojtjes, edhe pas përfundimit të tij;

c) të mënjanojë çdo veprim ose mosveprim, që mund të rrezikojë zbatimin e programit të mbrojtjes apo që mund të sjellë, si pasojë, një gjendje tjetër rreziku për personin e mbrojtur;

ç) të informojë menjëherë drejtorinë për çështje që kërkohen prej saj, ose për ngjarje apo ndryshime të rrethanave të jetës a veprimtarive të tij personale, si dhe për kontaktet e marrëdhëniet me të tretë, që mund të rrezikojnë zbatimin dhe garancitë e ofruara nga programi i mbrojtjes;

d) të pranojë, pa nevojën e një vendimi gjyqësor të posaçëm, nëse është e domosdoshme për qëllimet e mbrojtjes apo të procedimit penal, përdorimin në mjediset e veta të mjeteve teknike të ruajtjes, vëzhgimit dhe regjistrimit pamor dhe/ose zanor;

dh) detyrime të tjera që drejtoria i çmon të domosdoshme, në varësi të natyrës dhe rrethanave të rastit konkret;

e) detyrimet për prindin apo kujdestarin, në rastin kur personi i mbrojtur është i mitur, ose kur atij i është hequr a kufizuar zotësia për të vepruar.

#### Neni 21

### **Përjashtimi i punonjësve të drejtorisë nga përgjegjësia civile**

Ndaj punonjësit të drejtorisë nuk mund të ngrihet padi civile nga personat e pranuar në programin e mbrojtjes për veprimet dhe/ose mosveprimet e kryera në mirëbesim gjatë ushtrimit të një detyre të ngarkuar nga ky ligj.

#### Neni 22

### **Masa të jashtëzakonshme mbrojtjeje**

1. Policia e Shtetit, institucionet e paraburgimit ose institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, sipas nivelit të gjendjes së rrezikut për dëshmitarët, bashkëpunëtorët e drejtësisë dhe personat e lidhur me ta, mund të urdhërojnë dhe zbatojnë masa mbrojtjeje të jashtëzakonshme, sipas përcaktimeve të parashikuara në këtë ligj apo në ligje ose akte të tjera, që rregullojnë veprimtarinë e tyre. Këto masa, jo më vonë se 24 orë nga marrja e tyre, i njoftohen prokurorit që procedon.

2. Masat e jashtëzakonshme, me pëlqimin e prokurorit që procedon, mund të zgjaten derisa të mënjanohet rreziku, që ka motivuar marrjen e tyre ose deri në marrjen e vendimit përkatës nga komisioni.

#### Neni 23

### **Ndërprerja e programit të mbrojtjes**

1. Programi i mbrojtjes mund të ndërpritet nga komisioni në këto raste:
  - a) nëse gjatë hetimit dhe gjykimit të çështjes penale vërtetohet se dëshmitari ose bashkëpunëtori i drejtësisë bën deklarime a dëshmi të rreme apo, për çfarëdo arsye, nuk i jep deklaratimet ose dëshmitë, për të cilat u lejua pranimi në programin e mbrojtjes;
  - b) nëse personi i mbrojtur kryen një vepër penale me dashje;
  - c) nëse pas fillimit të zbatimit të programit të mbrojtjes sigurohen të dhëna të arsyeshme dhe të bazuara për përfshirjen e personit të mbrojtur në veprimtari kriminale, të padeklaruara prej tij;
  - ç) nëse dëshmitari, bashkëpunëtori i drejtësisë ose persona të tjerë të mbrojtur nuk respektojnë detyrimet e përmendura në marrëveshjen e mbrojtjes dhe/ose kushtet e bashkëpunimit me drejtësinë;
  - d) nëse një autoritet i një shteti tjetër kërkon mbarimin e programit të mbrojtjes, të zbatuar në territorin e atij shteti.
2. Gjatë shqyrtimit të rrethanave të ndërprerjes së programit të mbrojtjes, komisioni vihet në dijeni vetëm për arsyet e ndërprerjes së programit.

#### Neni 24

### **Përfundimi i programit të mbrojtjes**

1. Programi i mbrojtjes përfundon në rastet e mëposhtme:
  - a) nëse vlerësohet se nuk ekziston më gjendja e rrezikut, që motivon zbatimin e programit të mbrojtjes;
  - b) nëse personi i mbrojtur ka vdekur;
  - c) me kërkesë, me shkrim, të personit të mbrojtur ose të kujdestarit të tij.
2. Pas përfundimit të programit të mbrojtjes, personi i mbrojtur mund të zgjedhë mbajtjen e identitetit të ri, nëse i është dhënë një i tillë, ose marrjen përsëri të identitetit të tij të vërtetë.
3. Nëse personi, ndaj të cilit zbatohet programi i mbrojtjes, vritet ose dëmtohet fizikisht, në masën që bëhet i paaftë për punë, për shkak të dështimit të masave të zbatuara të mbrojtjes, me propozimin e drejtorisë, komisioni mund t'i caktojë personit ose anëtarëve të familjes, që kanë qenë në ngarkim të tij, ndihmë financiare të posaçme.

#### Neni 25

### **Njoftime për ndërprerjen ose përfundimin e programit të mbrojtjes**

*(shtuar fjalë me ligjin nr. 32/2017, datë 30.3.2017)*

1. Drejtoria njofton menjëherë, me shkrim, Prokurorin e Përgjithshëm ose Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme për rrethanat e përmendura në nenet 23 e 24 të këtij ligji.
2. Në rastin e kërkesës për përfundimin e programit të mbrojtjes ose kur ka vdekur personi i mbrojtur, programi i mbrojtjes përfundon menjëherë për kërkuuesin a personin e vdekur, por ai mund të vazhdojë, në varësi të rrethanave, për personat e tjerë të mbrojtur, të përfshirë në të.

#### Neni 26

### **Procedura e ankimit**

1. Personi i mbrojtur ka të drejtë të ankohet para komisionit dhe të kërkojë ndryshimin ose plotësimin e masave të zgjedhura, që duhet të zbatohen ndaj tij nga drejtoria, duke parashtruar shkaqet. Afati për të paraqitur ankimin është 5 ditë, duke filluar nga dita e nesërme e komunikimit të vendimit të drejtorisë. Ankimi nuk pezullon zbatimin e masës së zgjedhur. Vendimi i komisionit është përfundimtar.

2. Gjatë shqyrtimit të ankimit, sipas pikës 1 të këtij neni, komisioni nuk vihet në dijeni të hollësive që zbulojnë identitetin dhe vendndodhjen e deriatëhershme të personit që është në programin e mbrojtjes.

## KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

### Neni 27

#### **Bashkëpunimi ndërkombëtar**

1. Bashkëpunimi ndërkombëtar realizohet në bazë të të drejtave dhe detyrimeve, që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, ose nëpërmjet marrëveshjeve, për raste konkrete, të lidhura nga drejtori i drejtorisë me njësi të ngjashme në vende të tjera.

2. Marrëveshjet për programe mbrojtjeje konkrete mund të parashikojnë zbatimin e ndërsjellë të programit të mbrojtjes, përfshirë ndryshimin e vendbanimit dhe qëndrimin e personave të mbrojtur në territoret përkatëse të palëve.

3. Marrëveshjet për rastet konkrete përbëjnë “Informacion të klasifikuar” dhe për nënshkrimin e tyre nuk zbatohen rregullat e përgjithshme si në rastin e marrëveshjeve ndërkombëtare, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

### Neni 28

#### **Aktet nënligjore**

*(shtuar pika 1/1 dhe ndryshuar pika 2 me ligjin me ligjin nr.10 461, datë 13.9.2011)*

Brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, miratohen aktet nënligjore në zbatim të tij, si më poshtë:

1. Vendim i Këshillit të Ministrave për trajtimin dhe përfitimet e punonjësve të Drejtorisë së Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, në zbatim të pikës 4 të nenit 5 të këtij ligji.

1/1. Vendim i Këshillit të Ministrave për shpërblimin financiar të kryetarit dhe anëtarëve të komisionit, në zbatim të pikës 7 të nenit 9 të këtij ligji.

2. Udhëzim i përbashkët i Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Drejtësisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm për:

a) rregullat dhe kriteret e hollësishme për çështjet e parashikuara në pikat 1, 2 e 3 të nenit 10 të këtij ligji;

b) rregullat e hollësishme për detyrat, përgjegjësitë, format dhe procedurat e bashkërendimit e të informimit, ndërmjet institucioneve, në zbatim të nenit 13 të këtij ligji;

c) kriteret dhe procedurat për ruajtjen, administrimin dhe klasifikimin e informacionit për programin e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, në zbatim të pikës 1 të nenit 14 të këtij ligji;

ç) rregullat e hollësishme për rastet, procedurat dhe mënyrat e zbatimit të masave të mbrojtjes, në zbatim të neneve 15, 16 e 18 të këtij ligji.

3. Udhëzim i përbashkët i Ministrit të Brendshëm dhe i Ministrit të Financave për:

a) administrimin e pasurive dhe të fondeve të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së drejtorisë, dokumentimin e shpenzimeve dhe kontrollin e veprimtarisë financiare të drejtorisë, në zbatim të pikës 3 të nenit 5 të këtij ligji;

b) mënyrën e caktimit të ndihmës financiare dhe masën e saj, në zbatim të nenit 12 të këtij ligji.

4. Rregullore e brendshme e drejtorisë për:

a) rregullat me karakter teknik dhe operativ për kushtet, metodikat dhe procedurat e

verifikimit, të përgatitjes dhe zbatimit të programit të mbrojtjes, për mënyrat, format e mjetet e komunikimit, si dhe për administrimin e akteve e të informacionit, që lidhet me veprimtarinë e vet, në zbatim të nenit 6 të këtij ligji;

b) rregullat dhe kriteret e hollësishme për përmbajtjen, kuptimin, përshtatshmërinë, mënyrën dhe procedurat e caktimit dhe të shkallëzimit të masave, që përbëjnë programin e mbrojtjes;

c) rregullat e hollësishme për procedurat e shprehjes së vullnetit, bisedimit dhe nënshkrimit, për formën dhe përmbajtjen, si dhe për ndjekjen e zbatimit të kushteve të marrëveshjes së mbrojtjes, në zbatim të neneve 19 e 20 të këtij ligji.

5. Rregullore e brendshme e komisionit për rregullat e hollësishme për kriteret dhe procedurat e punës, për thirrjen dhe pjesëmarrjen në mbledhjet e tij, mungesën dhe pamundësinë e caktimit dhe të kryerjes së kësaj detyre.

6. Udhëzimet e titullarëve të institucioneve për depozitimin, mbajtjen dhe administrimin e informacionit për programin e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, në zbatim të pikës 2 të nenit 14 të këtij ligji.

#### Neni 29 **Shfuqizime**

Ligji nr.9205, datë 15.3.2004 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, shfuqizohet.

#### Neni 30 **Dispozita kalimtare**

1. Mandati i anëtarëve të komisionit, i filluar në përputhje me ligjin nr.9205, datë 15.3.2004 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, do të vazhdojë deri në përfundim të mandatit të tyre.

2. Deri në miratimin e akteve nënligjore, sipas nenit 28 të këtij ligji, zbatohen aktet nënligjore, të miratuara në zbatim të ligjit nr.9205, datë 15.3.2004 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj.

#### Neni 31 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6324, datë 5.11.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**